



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON CULTURAL HERITAGE<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O KULTURNO NASLEĐE<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Trashëgiminë Kulturore, është miratuar në mbledhjen e 21– të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.02/21 me datë 01.04.2015

<sup>2</sup> Draft law on Cultural Heritage, was approved in the 21-meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision no. 02/21 dt. 01.04.2015

<sup>3</sup> Nacrt zakona o Kulturno Nasleđe, usvojenje na 21-oj sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br.02/21 od 01.04.2015.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR TRASHËGIMINË KULTURORE</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi i ligjit</b></p> <p>1. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja dhe ruajtja e pronave, objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe përcaktimi i masave ligjore dhe teknike për inventarizim, hulumtim, dokumentim, përzgjedhje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe promovim të trashëgimisë kulturore në pajtim me kartat, konventat dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare.</p> <p>2. Ky ligj përcakton ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, promovimin, komunikimin dhe sigurimin e burimeve të domosdoshme</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Approves:</p> <p><b>LAW ON CULTURAL HERITAGE</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1 Aim of the law</b></p> <p>1. The aim of this law is the protection and preservation of property, facilities and values of Kosovo cultural heritage and determination of legal and technical measures for inventory, research, documenting, selection, conservation, restoration, administration, presentation and promotion of cultural heritage in accordance with charters, conventions and other international instruments.</p> <p>2. This law defines the preservation, protection, public access, promotion, communication and provision of necessary</p>	<p>Skupština Republike Kosova, U skladu sa članom 65 (1) ustava Republike Kosova, Usvaja:</p> <p><b>ZAKONA O KULTURNO NASLEĐE</b></p> <p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1 Svrha zakona</b></p> <p>1. Svrha ovog zakona je zaštita i očuvanje imovine, objekata i vrednosti kulturnog nasleđa Kosova i određivanje pravnih i tehničkih mera za popisivanje, istraživanje, dokumentovanje, selekciju, čuvanje, restauraciju, administraciju, predstavljanje i promovisanje kulturnog nasleđa u skladu sa poveljama, konvencijama i ostalim međunarodnim instrumentima.</p> <p>2. Ovaj zakon određuje očuvanje, zaštitu, javni pristup, promovisanje, komunikaciju i obezbeđivanje neophodnih izvora</p>
---	---	--

<p>të trashëgimisë kulturore me qëllim që ajo të shfrytëzohet nga gjeneratat e tashme dhe t'u përcillet gjeneratave të ardhshme, si vlerë dhe pasuri kulturore dhe historike e Kosovës.</p> <p>3. Secili qytetar i Kosovës dhe secili qytetar prezent në Kosovë ka të drejtë ta gëzojë dhe ta ruajë trashëgiminë kulturore të Kosovës.</p> <p>4. Ky Ligj është në përputhshmëri me Direktivën 93/7/EEC e 15 marsit 1993 mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Shtetit Anëtar, Direktiva 96/100/EC e 17 shkurtit 1997 që ndryshon Shtojcën e Direktivës 93/7/EEC mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Shtetit Anëtar, Direktiva 2001/38/EC, 5 qershor 2001 që ndryshon Shtojcën e Direktivës 93/7/EEC mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Shtetit Anëtar si dhe Rregullorja (EC) Nr. 116/2009 e datës 18 dhjetor 2008 mbi eksportimin e mallrave kulturore.</p>	<p>resources of cultural heritage so that it is used by current generations and passed on to future generations, as the value and historical and cultural wealth of Kosovo.</p> <p>3. Every citizen of Kosovo and every citizen present in Kosovo has the right to enjoy and duty to preserve the cultural heritage of Kosovo.</p> <p>4. The present Law is in compliance with Directive 93/7/EEC of 15 March 1993 on return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State, Directive 96/100/EC of 17 February 1997 amending the Annex of Directive 93/7/EEC on return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State, Directive 2001/38/EC, 5 June 2001 amending the Annex of Directive 93/7/EEC on return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State and Regulation (EC) No. 116/2009 dated 18 December 2008 on export of cultural goods.</p>	<p>kulturnog nasleđa, kako bi se isto koristilo od strane trenutnih generacija i propratilo sledećim generacijama, kao vrednost i kulturno i istorijsko bogatstvo Kosova.</p> <p>3. Svaki građanin Kosova i svaki građanin koji je prisutan na Kosovu ima pravo da uživa i obavezu da čuva kulturno nasleđe Kosova.</p> <p>4. Ovaj zakon je u skladu sa direktivom 93/7/EEC od 15 marta 1993 godine, o vraćanju kulturnih objekata koji su na nezakonit način udaljene sa teritorije zemlje članice, direktiva 96/100/EC od 17 februara 1997 godine, koja izmenjuje dodatak direktive 93/7/EEC o vraćanju kulturnih objekata koji su na nezakonit način udaljene sa teritorije zemlje članice, direktiva 2001/38/EC od 5 juna 2001 godine, koja izmenjuje dodatak direktive 93/7/EEC o vraćanju kulturnih objekata koji su na nezakonit način udaljene sa teritorije zemlje članice kao i uredba (EC) br. 116/2009 d 18 decembra 2008 godine o izvozu kulturnih dobara.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Ky ligj rregullon marrëdhëniet midis</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p> <p>1. This law regulates relations between</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Oblast delovanja</b></p> <p>1. Ovaj zakon reguliše odnose između</p>

<p>pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, qofshin ata individë, komunitete ose institucione publike.</p> <p>2. Ky ligj përcakton të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e personave fizikë dhe juridikë për trashëgiminë kulturore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Ligji për Trashëgimin Kulturore përkufizohet si në vijim:</p> <p>1.1. <b>Adaptim</b> – ndryshim në përdorim të trashëgimisë kulturore në përshtatje me nevojat bashkëkohore.</p> <p>1.2. <b>Administrim</b> – mbikëqyrje dhe menaxhim i trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.3. <b>Ansambël</b> – grup i ndërtesave urbane ose rurale, i veçuar për nga vlerat historike, arkeologjike, arkitekturore dhe artistike, me interes shkencor, shoqëror dhe teknik, që formon njësi të caktuar topografike</p>	<p>owners, possessors and users of cultural heritage, be them individuals, communities or public institutions.</p> <p>2. This law defines the rights, duties, responsibilities and obligations natural and legal persons for cultural heritage.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. The Law on Cultural Heritage is defined as follows:</p> <p>1.1. <b>Adoption</b> – amendment in use of Cultural Heritage in into suiting to contemporary needs.</p> <p>1.2. <b>Administration</b> – supervision and management of cultural heritage.</p> <p>1.3. <b>Ensemble</b> – group of urban or rural buildings, specified by historical, archaeological, architectural and artistic value of scientific, social and technical interest forming certain topographic units.</p>	<p>vlasnika, posednika i korisnika kulturnog nasleđa, bilo das u to pojedinci, zajednice ili javne institucije.</p> <p>2. Ovaj zakon određuje prava, dužnosti i odgovornosti i obaveze fizičkih i pravnih lica za kulturno nasleđe.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Zakon za kulturno nasledje se definise kao sledece</p> <p>1.1. <b>Adaptacija</b> – promena u Korišćenju kulturnog nasleđa u skladu sa savremenim potrebama.</p> <p>1.2. <b>Administracija</b> – nadgledanje i upravljanje kulturnim nasleđem.</p> <p>1.3. <b>Ansambel</b> – grupa gradskih i seoskih zgrada, koje su karakteristilne po istorijskim, arheološkim, arhitektonskim i umetničkim vrednostima, od naučnog, društvenog i tehničkog interesa, što formira određene topografske jedinice.</p>
---	--	--

<p>1.4. <b>Artefakt</b> – objekt i luajtshtëm me vlera trashëgimore i krijuar nga njeriu.</p> <p>1.5. <b>Dëmtim</b> – ndërhyrje që cenon pronën dhe vlerat e trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.6. <b>Dokumentim</b> – paraqitje e vlerave tipologjike dhe faktike përmes mjeteve grafike, fotografike, audiovizuele dhe të dhënave të shkruara.</p> <p>1.7. <b>Inventarizim</b> – hulumtimi zyrtar për regjistrim dhe dokumentim të trashëgimisë kulturore. Inventarizimi paraqet bazën mbi të cilën mund të bëhet një vlerësim (a) për të përcaktuar nëse trashëgimia kulturore duhet të mbrohet me ligj dhe (b) për të përgatitur planin për konservim.</p> <p>1.8. <b>Institucion përgjegjës</b> – institucion në vartësi të Ministrisë përgjegjës për hulumtimin, dokumentimin, ruajtjen, konservimin, restaurimin, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Institucionet përgjegjëse janë: Instituti i Arkeologjisë i Kosovës, Qendra e Kosovës për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, Muzeu i Kosovës, Muzeu i</p>	<p>1.4. <b>Artifacts</b> – movable objects with heritage values created by man.</p> <p>1.5. <b>Damage</b> – interference that threatens property and cultural heritage values.</p> <p>1.6. <b>Documenting</b> – presentation of typological and factual values by graphic, photographic, audiovisual means and written records.</p> <p>1.7. <b>Inventorying</b> – official research for registration and documentation of cultural heritage. Inventory represents the basis on which an evaluation is made (a) to determine whether cultural heritage must be protected by law and (b) to prepare the conservation plan.</p> <p>1.8. <b>Responsible institution</b> – institution under the responsible Ministry for research, documenting, preservation, conservation, restoration, administration and promotion of cultural heritage. Responsible institutions are as follows: Archaeological Institute of Kosovo, Kosovo Center for Protection of Cultural Heritage – KCPCH, Kosovo</p>	<p>1.4. <b>Artefakt</b> – pokretni objekat nasledne vrednosti koji je stvorio čovek.</p> <p>1.5. <b>Oštećenje</b> – smetnja koja narušava imovinu i vrednosti kulturnog nasleđa.</p> <p>1.6. <b>Dokumentovanje</b> – predstavljanje tipoloških i činjeničnih vrednosti putem grafičkih, fotografijskih, audiovizuelnih i pisanih podataka.</p> <p>1.7. <b>Popisivanje</b> – službeno istraživanje za registrovanje i dokumentovanje kulturnog nasleđa. Popisivanje predstavlja osnovu na kojoj se vrši procena (a) za određivanje činjenice da li kulturno nasleđe treba da se zakonom štiti; i (b) za pripremu plana za očuvanje.</p> <p>1.8. <b>Odgovorna institucija</b> – institucija u nadležnosti ministarstva, odgovorna za istraživanje, dokumentovanje, čuvanje, zaštitu, restauraciju, administraciju i promovisanje kulturnog nasleđa. Odgovorne institucije su: arheološki institute Kosova, Kosovski centar za zaštitu kulturnog nasleđa – KCZKN, Kosovski muzej, muzej prirode.</p>
---	--	---

<p>Natyrës.</p> <p>1.9. <b>Institucion relevant</b> – institucioni që ka përgjegjësi të caktuar me mandat për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore: Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunitet, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencioni Kadastral dhe institucionet e tjera.</p> <p>1.10. <b>Konservim</b> – masat dhe veprimet që merren për ruajtjen e trashëgimisë kulturore pa humbur autenticitetin, domëthenien, rëndësinë kulturore, historike dhe artistike të saj.</p> <p>1.11. <b>Konservim i integruar</b> – mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore e përfshirë në procesin e planifikimit dhe menaxhimit, urban, si dhe bazuar në premisat e zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>1.12. <b>Konsolidim</b> – masë e ndërmarrë për të përforcuar strukturën dhe materialet e dëmtuara në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe integriteti i pronës dhe vlerës së trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.13. <b>Listë e Trashëgimisë</b></p>	<p>Museum, Museum of Nature.</p> <p>1.9. <b>Relevant institution</b> – institution that has the responsibility to define the mandate for protection and preservation of cultural heritage: Ministry of Environment and Spatial Planning, Municipalities, Ministry of Trade and Industry, Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development, Cadastral Agency and other institutions.</p> <p>1.10. <b>Conservation</b> – measures and actions taken for preservation of cultural heritage without losing its authenticity, meaning, cultural, historical and artistic importance.</p> <p>1.11. <b>Integrated conservation</b> – protection and preservation of cultural heritage included in the process of planning and management, urban and basen on premises of sustainable development.</p> <p>1.12. <b>Consolidation</b> – measure undertaken to reinforce the damaged structure and materials in order to ensure sustainability and integrity of the property and value of cultural heritage heritage.</p> <p>1.13. <b>List of the Cultural Heritage</b></p>	<p>1.9. <b>Relevantna institucija</b> – institucija koja ima određenu odgovornost sa mandatom za zaštitu i očuvanje kulturnog nasleđa: ministarstvo okoline i prostornog planiranja, opštine, ministarstvo trgovine i industrije, ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, katastarska institucija i ostale institucije.</p> <p>1.10. <b>Očuvanje</b> – mere i radnje koje se preduzimaju za očuvanje kulturnog nasleđa bez gubljenja svoje autentičnosti, značaja, kulturne, istorijske i umetničke važnosti.</p> <p>1.11. <b>Integrisano očuvanje</b> – zaštita i očuvanje kulturnog nasleđa obuhvaćenog u procesu planiranja i urbanog upravljanja, zasnovanog na pretpostavkama održivog razvoja.</p> <p>1.12. <b>Konsolidacija</b> – preduzete mere za jačanje oštećene strukture i materijala kako bi se obezbedila održivost i integritet imovine i vrednosti kulturnog nasleđa.</p> <p>1.13. <b>Lista kulturnog nasleđa</b></p>
--	--	--

<p><b>Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme</b> – përfshin trashëgiminë kulturore të inventarizuar dhe përzgjedhur për mbrojtje dhe ruajtje të përkohshme nga Ministria me rekomandim të institucioneve përgjegjëse (më tej: Lista).</p> <p>1.14. <b>Lokalitet</b> – hapësirë që përmban vepër të njeriut ose të kombinuar mes natyrës dhe dorës së njeriut, e veçuar nga interesi historik, arkeologjik, arkitekturor, artistik, shoqëror, shkencor ose teknik.</p> <p>1.15. <b>Mbajtës</b> – personi që e mban fizikisht objektin kulturor për palët e treta.</p> <p>1.16. <b>Mbrojtje</b> – masë ligjore për ruajtjen e trashëgimisë kulturore si pronë dhe vlerë.</p> <p>1.17. <b>Ministër</b> – Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.</p> <p>1.18. <b>Ministria</b> – MKRS.</p> <p>1.19. <b>Monument</b> – ndërtim dhe strukturë e veçuar për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike,</p>	<p><b>under Temporary Protection</b> – includes cultural heritage inventoried and selected for temporary protection and conservation by the Ministry on the recommendation of the responsible institutions (hereinafter: The List).</p> <p>1.14. <b>Locality</b> – space that contains a human work or in combination between nature and human hand, specified by historical, archaeological, architectural, artistic, social, technical or scientific interest.</p> <p>1.15. <b>Holder</b> – the person who physically holds the cultural object for third parties.</p> <p>1.16. <b>Protection</b> – legal measures for the preservation of cultural heritage as property and value.</p> <p>1.17. <b>Minister</b> – Minister of the Ministry of Culture, Youth and Sports of the Republic of Kosovo -MCYS.</p> <p>1.18. <b>Ministry</b> – MCYS.</p> <p>1.19. <b>Monument</b> – specific construction and structure because of its historical, archaeological, artistic,</p>	<p><b>za privremenu zaštitu</b> – obuhvata kulturno nasleđe koje je popisano i izabrano za privremenu zaštitu i očuvanje od strane ministarstva, preporukom relevantnih institucija (u daljem tekstu Lista).</p> <p>1.14. <b>Lokalitet</b> – prostor koji u sebi sadrži čovekovo delo ili kombinovano delo prirode i čovekove ruke, karakteristično po istorijskom, arheološkom, arhitektonskom, umetničkom, društvenom, naučnom ili tehničkom interesu.</p> <p>1.15. <b>Nosilac</b> – osoba koja fizički nosi kulturni objekat za treća lica.</p> <p>1.16. <b>Zaštita</b> – pravna mera za očuvanje kulturnog nasleđa kao imovine i vrednosti.</p> <p>1.17. <b>Ministar</b> – ministar ministarstva culture, omladine i sporta - MKOS.</p> <p>1.18. <b>Ministarstvo</b> – MKOS.</p> <p>1.19. <b>Spomenik</b> – izgradnja i struktura karakteristična po istorijskoj, arheološkoj, umetničkoj, naučnoj</p>
--	--	--

<p>shkencore, me interes shoqëror ose teknik, që përfshin elementet e luajtshme si pjesë të saj;</p> <p>1.20. <b>Muze</b> – institucion i hapur për publikun që hulumton, konservon mbledh, komunikon dhe paraqet trashëgiminë materiale dhe shpirtërore me qëllim të njohjes, studimit, edukimit dhe rekreacionit.</p> <p>1.21. <b>Ndërhyrje</b> – veprim i ndërmarrë përmes konservimit, restaurimit, rikonstruimit, rehabilitimit, adaptimit, revitalizimit dhe konsolidimit, me përjashtim të demolimit ose shkatërrimit, që rezulton me ndryshime fizike në trashëgiminë kulturore.</p> <p>1.22. <b>Park arkeologjik</b> – sipërfaqe e mbrojtur me rëndësi të veçantë arkeologjike, që ka potencial për të qenë burim për studim, interpretim, edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm.</p> <p>1.23. <b>Peizazh kulturor</b> – hapësirë me vlera të trashëgimisë kulturore e krijuar në kombinim të natyrës dhe punës së njeriut.</p> <p>1.24. <b>Perimetër i monumentit</b> – kufi zyrtar i pronës së trashëgimisë</p>	<p>scientific, social or technical interest values, which includes the movable elements as part of it;</p> <p>1.20. <b>Museum</b> – open institution to the public which explores, preserves, collects, communicates and presents or publishes material and spiritual heritage with the purpose of recognition, research, education and recreation.</p> <p>1.21. <b>Intervention</b> – action taken through conservation, restoration, reconstruction, rehabilitation, adaptation, revitalization and consolidation, with the exception of damage or destruction, resulting in physical changes in the cultural heritage.</p> <p>1.22. <b>Archaeological Park</b> – protected area of particular archaeological importance, which has the potential to be a source for the study, interpretation, education and sustainable development.</p> <p>1.23. <b>Cultural Landscape</b> – space with cultural heritage values created in combination of nature and work of man.</p> <p>1.24. <b>Perimeter of monument</b> - an official boundary of the property for the</p>	<p>vrednosti, društvenog ili tehničkog interesa, koja obuhvata pokretne elemente kao deo sebe;</p> <p>1.20. <b>Muzej</b> – institucija otvorena javnosti koja istražuje, štiti, sakuplja, komunicira i predstavlja ili objavljuje materijale nasleđa i duševne materijale sa ciljem prepoznavanja, studiranja, obrazovanja i rekreacije.</p> <p>1.21. <b>Intervencija</b> – akcija preduzeta putem očuvanja, restauracije, rekonstrukcije, sanacije, adaptacije, revitalizacije i konsolidacije, sa izuzetkom rušenja ili uništenja, što rezultira u fizičkim izmenama na kulturnom nasleđu.</p> <p>1.22. <b>Arheološki park</b> – zaštićena površina od posebne arheološke važnosti koja poseduje potencijal da postane izvor studiranja, interpretacije, obrazovanja i održivog razvoja.</p> <p>1.23. <b>Kulturni pejzaž</b> – prostor vrednosti kulturnog nasleđa, stvorenog u kombinaciji prirode i čovekove ruke.</p> <p>1.24. <b>Obim spomenika</b> – službena rranica imovine kulturnog nasleđa koja</p>
---	--	---



<p>kulturore që përcaktohet me plan nga Ministria dhe institucionet e tjera relevante.</p> <p>1.25. <b>Posedues</b> – person i cili mban pronën e trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.26. <b>Promovim</b> – veprimtari edukative dhe kulturore me qëllim të njohjes dhe vetëdijësimit për vlerat e trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.27. <b>Pronar</b> – person fizik ose juridik i cili ligjërisht zotëron pronën e trashëgimisë kulturore dhe ka të drejtën e përdorimit të saj në pajtim me ligjet në fuqi.</p> <p>1.28. <b>Pronë e trashëgimisë kulturore</b> –pronë e luajtshme ose e paluajtshme që është nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme të shtetit.</p> <p>1.29. <b>Rehabilitim</b> – ndërhyrje që e mundëson përdorimin bashkëkohor të pronës, duke ruajtur pjesën më të madhe të tipareve origjinale të saj.</p> <p>1.30. <b>Regjistër Nacional i Trashëgimisë Kulturore</b> (më tej: Regjistri) - listë ku regjistrohet trashëgimia kulturore për mbrojtje të</p>	<p>cultural heritage, which is determined by the plan by the Ministry and other relevant institutions.</p> <p>1.25. <b>Possessor</b> – a person who holds property of cultural heritage.</p> <p>1.26. <b>Promotion</b> – educational and cultural activities with the purpose of recognition and raising awareness for the values of cultural heritage.</p> <p>1.27. <b>Owner</b> – natural or legal person who legally owns property of cultural heritage and has the right of its use in accordance with the applicable laws.</p> <p>1.28. <b>Property of cultural heritage</b> – property of movable and immovable assets which is under temporary or permanent protection of the state.</p> <p>1.29. <b>Rehabilitation</b> – intervention that enables the contemporary use of property, preserving most of its original features.</p> <p>1.30. <b>National Registry of Cultural Heritage</b> (hereinafter: Registry) - list of areas where cultural heritage is registered for permanent</p>	<p>se odredjuje planom od strane ministarstva i ostalih relevantnih institucija.</p> <p>1.25. <b>Posednik</b> – osoba koja poseduje imovinu kulturnog nasleđa.</p> <p>1.26. <b>Promovisanje</b> – obrazovna i kulturna delatnost sa ciljem upiznavanja i podizanja svesti o vrednostima kulturnog nasleđa.</p> <p>1.27. <b>Vlasnik</b> – fizičko ili pravno lice koje punopravno poseduje imovinu kulturnog nasleđa i ima pravo korišćenja iste u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>1.28. <b>Imovina kulturnog nasleđa</b> –ppokretna i nepokretna imovina koja je pod privremenom ili stalnom zaštitom države.</p> <p>1.29. <b>Rehabilitacija</b> – intervencija koja omogućava modern korišćenje imovine, čuvajući najveći deo njenih originalnih karakteristika.</p> <p>1.30. <b>Nacionalni registar kulturnog nasleđa</b> (u daljem tekstu: registar) – lista u kojoj se registruje kulturno nasleđe za stalnu zaštitu koja</p>
---	---	--

<p>përhershme që del nga Lista e Përkohshme, pas vlerësimit nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.</p> <p>1.31. <b>Restaurim</b> – veprimtari që ka për qëllim ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerës estetike dhe historike të pronës, me materiale ekzistuese, duke u mbështetur në origjinalitetin dhe dokumentet autentike.</p> <p>1.32. <b>Revitalizim</b> – rijetësim i pronës së trashëgimisë kulturore mbështetur në zhvillim të qëndrueshëm.</p> <p>1.33. <b>Rezervë arkeologjike</b> – pronë e trashëgimisë kulturore me potencial arkeologjik, të dukshëm ose të padukshëm, që mbrohet dhe ruhet për studim për gjeneratat e ardhshme.</p> <p>1.34. <b>Rikonstruim</b> – veprim që ndërmerret ndaj një prone me vlera kulturore dhe historike për qëllim të ripërtërirjes së pjesshme apo të plotë në bazë të dokumentacionit autentik dhe që veçohet me përdorimin e materialeve të reja dhe të vjetra.</p>	<p>protection that emerges from the Provisional List, after the evaluation by Kosovo Council of Cultural Heritage and after its signature by the Minister.</p> <p>1.31. <b>Restoration</b> – activities with the aim of preserving and highlighting aesthetic and historical value of the property, with existing materials, based on authentic documents and originality.</p> <p>1.32. <b>Revitalization</b> – reinstating the property of cultural heritage based on sustainable development.</p> <p>1.33. <b>Archaeological Reserve</b> – property of cultural heritage with archaeological potential, visible or invisible, which is protected and preserved for the study of future generations.</p> <p>1.34. <b>Reconstruction</b> – action that is undertaken to a property with cultural and historical value for the purpose of partial or full restoring based on authentic documentation and that is specified by use of old and new materials.</p>	<p>proizilazi iz privremene liste, nakon procene Kosovskog saveta za kulturno nasleđe i nakon potpisivanja od strane ministra.</p> <p>1.31. <b>Restauracija</b> – aktivnost čiji je cilj očuvanje i otkrivanje estetske i istorijske vrednosti imovine i postojećih materijala, oslanjajući se na originalnost i autentične dokumente.</p> <p>1.32. <b>Revitalizacija</b> – ponovno oživljavanje imovine kulturnog nasleđa zasnovanog na održivi razvoj.</p> <p>1.33. <b>Arheološke reserve</b> – imovina kulturnog nasleđa arheološkog potencijala, vidljivog ili nevidljivog, koja se štiti i čuva za buduće generacije.</p> <p>1.34. <b>Rekonstrukcija</b> – akcija koja se preuzima na nakoj imovini sa kulturnim i istorijskim vrednostima, sa ciljem delimičnog ili potpunog obnavljanja iste, na osnovu autentične dokumentacije i koja se karakteriše korišćenjem novih i starih materijala.</p>
--	--	--

<p>1.35. <b>Riparim urgjent</b> –intervenim i shpejtë me qëllim rregullimi në pronat e trashëgimisë kulturore, të dëmtuara nga njeriu, fatkeqësitë natyrore ose nga lënia pasdore.</p> <p>1.36. <b>Ruajtje</b> – ndërmarrje e masave të domosdoshme për të parandaluar dëmtimin e gjendjes ekzistuese dhe vlerën e pronave të trashëgimisë kulturore dhe për të zgjatur ekzistencën e saj.</p> <p>1. 37. <b>Sipërfaqe e mbrojtur</b> – nënkupton hapësirën e përcaktuar për qëllime të ruajtjes së burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, mbrojtje nga ndotja e mjedisit ose krijim të kushteve hapësinore për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë, si dhe sigurinë e banorëve dhe të zonave përreth, e cila duhet të përcaktohet në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës dhe që mund të klasifikohet nga Ministria respektive si Zonë e Veçantë. Përkufizohet me Ligjin Nr. 04/L-174.</p> <p>1.38. <b>Shfrytëzues</b> – personi fizik dhe juridik i cili e gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës.</p> <p>1.39. <b>Trashëgimi kulturore</b> – evidencë materiale dhe shpirtërore e</p>	<p>1.35. <b>Emergency Repair</b> – immediate intervention in order to fix property of cultural heritage, damaged by man, natural disasters or by leaving it without due care.</p> <p>1.36. <b>Preservation</b> – undertaking necessary measures to prevent damage to the existing situation and property value of the cultural heritage and to extend its existence.</p> <p>1.37. <b>Protected Area</b> - means the area defined for the purposes of conservation of natural resources and cultural heritage, protection from pollution of the environment or creation of spatial conditions for the exercise of the activity and safety of the residents and surrounding areas, which should be determined in the Spatial Plan of Kosovo and Zonal Map of Kosovo and it can be classified by the respective Ministry as a Special Area which is defined by Law No. 04/L-174 on Spatial Planning.</p> <p>1.38. <b>User</b> – a natural person or legal entity, who enjoys the right of the use of the property.</p> <p>1.39. <b>Cultural Heritage</b> – material and spiritual evidence of a group or</p>	<p>1.35. <b>Hitna popravka</b> – brza intervencija za regulisanje imovina kulturnog nasleđa koje je oštetio factor čovek, prirodne katastrofe ili zanemarivanje.</p> <p>1.36. <b>Čuvanje</b> – preduzimanje mera neophodnih za sprečavanje oštećenja postojećeg stanja i vrednosti imovina kulturnog nasleđa i za produženje njenog postojanja.</p> <p>1.37. <b>Zaštićeno područje</b> – podrazumeva prostor određen za potrebe očuvanja prirodnih izvora i izvora kulturnog nasleđa, zaštita od zagađenja životne sredine ili stvaranja prostornih uslova za nesmetano sprovođenje delatnosti, kao i bezbednost stanovnika okolnih područja koja se treba odrediti u prostornom planu Kosova i karti područja Kosova, i koja se od strane ministarstva može klasifikovati kao specijalna zona koja se definiše zakonom Br. 04/L-174 za prostorno planiranje.</p> <p>1.38. <b>Korisnik</b> – fizičko ili pravno lice koježiva pravo korišćenja imovine.</p> <p>1.39. <b>Kulturno nasleđe</b> – materijalni i duševni dokazi jedne</p>
--	---	---

<p>një grupi ose shoqërie që është trashëguar nga gjeneratat e mëhershme, që mbrohet dhe ruhet sot dhe u bartet gjeneratave të ardhshme.</p>	<p>society that is inherited from previous generations, that is protected and preserved today and is transferred to the future generations.</p>	<p>grupe ili društva koje su nasleđene od ranijih generacija, koje se i dan danas čuvaju i štite i prenose budućim generacijama.</p>
<p>1.40. <b>Trashëgimi materiale</b> – përfshin trashëgiminë e paluajtshme dhe trashëgiminë e luajtshme.</p>	<p>1.40. <b>Material Heritage</b> – includes immovable heritage and movable heritage.</p>	<p>1.40. <b>Materijalno nasleđe</b> – obuhvata pokretno nasleđe i nepokretno nasleđe.</p>
<p>1.41. <b>Trashëgimi arkeologjike</b> - përfshin të gjitha gjurmët e ekzistencës njerëzore së bashku me vendet ku janë krijuar, si: kulturat, qytetërimet, komunikimet, si dhe vendbanimet, ndërtesat, strukturat, objektet e lëvizshme në tokë ose nën ujë.</p>	<p>1.41. <b>Archaeological Heritage</b> – includes all traces of human existence along with the places where they are created, such as cultures, civilizations, communications, as well as residences, buildings, structures, movable objects on land or under water.</p>	<p>1.41. <b>Arheološko nasleđe</b> – obuhvata sve tragove ljudskog postojanja zajedno sa mestima gde su stvarane kulture, civilizacija, komunikacije, kao i naselja, zgrade, strukture, pokretni objekti na zemlji ili ispod vode.</p>
<p>1.42. <b>Trashëgimi arkitekturore</b> – trashëgimi materiale që përbëhet nga monumentet, ansamblet dhe lokalitetet.</p>	<p>1.42. <b>Architectural Heritage</b> – material heritage monuments, which consist of ensembles and localities.</p>	<p>1.42. <b>Arhitektonsko nasleđe</b> – materijalno nasleđe koje se sastoji od spomenika, ansambla i lokaliteta.</p>
<p>1.43. <b>Trashëgimi e luajtshme</b> – evidencë materiale e kreativitetit njerëzor apo zhvillimit natyror që ka vlera kulturore, historike, kujtesore, shkencore dhe shpirtërore.</p>	<p>1.43. <b>Movable Heritage</b> – is material evidence of human creativity or natural development that has cultural, historical, memorable, scientific and spiritual value.</p>	<p>1.43. <b>Pokretno nasleđe</b> – je materijalni okaz ljudske kreativnosti ili prirodnog razvoja koje poseduje kulturne, istorijske, obeležavačke, naučne i duševne vrednosti.</p>
<p>1.44. <b>Trashëgimi e paluajtshme</b> – trashëgimia arkeologjike, trashëgimia arkitekturore dhe peizazhet kulturore.</p>	<p>1.44. <b>Immovable Heritage</b> – archaeological heritage, architectural heritage and cultural landscapes.</p>	<p>1.44. <b>Nepokretno nasleđe</b> – arheološko nasleđe, arhitektonsko nasleđe i kulturni pejzaži.</p>
<p>1.45. <b>Trashëgimi e shpirtërore</b> –</p>	<p>1.45. <b>Spiritual Heritage</b> – oral and</p>	<p>1.45. <b>Duševno nasleđe</b> – oralna</p>

<p>tradita dhe doket gojore, si: gjuha, dialektet dhe të folmet lokale, vlerat morale, etike dhe humane, simbolet dhe kujtesa kolektive, doket, zakonet dhe praktikrat rituale, kultet, mitet, legjendat dhe besimet popullore, dijet dhe reprezentimet mbi natyrën, lojërat dhe garat tradicionale, praktikrat festive, vallet, muzika dhe folklori burimor, dekorimi dhe praktikrat artistike, zejjet tradicionale dhe artizanatet, artet kulinare, shkathtësitë e mësuara të bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, gjuetisë, peshkimit, kopshtarisë, vreshtarisë, mjekësisë popullore duke përfshirë individët, grupet ose bashkësitë që i reprezentojnë ato, por edhe hapësirat kulturore të krijuara nga brezat e mëparshëm në interakcion me natyrën dhe mjedisin jetësor.</p>	<p>folk tradition and customs, such as: language, dialects and local dialects, moral, ethical and humane values, symbols and collective memory, folk customs, habits and ritual practices, cults, myths, legends and folk beliefs, knowledge and representations on the nature, games and competitions, traditional festive practices, dance, music and folklore source, the decoration and artistic practices, traditional crafts and handicrafts, culinary arts, agriculture learned skills, livestock, beekeeping, hunting, fishing, gardening, viticulture, and traditional medicine including individuals, groups or communities representing them, but also cultural area created from previous generations in an interaction with nature and living environment.</p>	<p>tradicija i navike, kao što je: jezik, dijalekat i lokalni dijalekti, moralne etičke i ljudske vrednosti, simboli i kolektivno pamćenje, navike, običaji i ritualne prakse, kultovi, mitovi, legende i narodna verovanja, znanja i zastupanja prirode, igre i tradicionalna takmičenja, prazničke prakse, kola, muzika i izvorni folklor, dekoracija i umetničke prakse, tradicionalni zanati i rukotvorine, kuvarske sposobnosti, naučene sposobnosti poljoprivrede, stočarstva, pčelarstva, lova, ribolova, baštovanstva, vinogradarstva, narodne medicine uključujući pojedince, grupe ili zajednice koje ih zastupaju, ali i kulturni prostori nastali tokom prethodnih generacija u interakciji sa prirodom i životnom okolinom.</p>
<p>1.46. <b>Trashëgimi natyrore</b> – pjesë integrale dhe në simbiozë me trashëgiminë kulturore që përbëhet nga formacionet fizike, biologjike, gjeologjike dhe lokalitetet natyrore me vlera të veçanta nga pikëpamja shkencore, ekologjike dhe estetike.</p>	<p>1.46. <b>Natural Heritage</b> - integral part and in symbiosis with cultural heritage that consists of physical, biological, geological formations and natural localities, of special values from the scientific, ecological and aesthetic point of view.</p>	<p>1.46. <b>Prirodno nasleđe</b> – sastavni deo i simbiotičan sa kulturnim nasleđem koje se sadrži od fizičkih, bioloških, geoloških formacija i prirodnih lokacija od posebnih vrednosti sa naučne, ekološke i estetske tačke gledišta.</p>
<p>1.47. <b>Valorizim i trashëgimisë kulturore</b> – proces i hulumtimit, dokumentimit dhe përzgjedhjes për</p>	<p>1.47. <b>Valorization of the Cultural Heritage</b> – a process of researching, documenting and selecting for</p>	<p>1.47. <b>Valorizacija kulturnog nasleđa</b> – proces istraživanja, dokumentovanja i selekcije za zaštitu,</p>

<p>mbrojtje, ruajtje, administrim dhe promovim të vlerave të trashëgimisë kulturore.</p> <p>1.48. <b>Vlerë trashëgimore</b> – vlerë e mishëruar me trashëgiminë materiale dhe shpirtërore, që përfshin vlerën estetike, historike, shkencore, sociale dhe shpirtërore të gjeneratave të kaluara, të tashme dhe që bartet te gjeneratat e ardhshme.</p> <p>1.49. <b>Zonë mbrojtëse</b> – zonë e përkufizuar sipas Ligjit Nr. 04/L-174, të Planifikimit Hapësinor.</p> <p>1.50. <b>Zonë e veçantë e mbrojtur</b> – zonë e përkufizuar sipas Ligjit Nr. 03/L-039, për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.</p> <p>1.51. <b>Zonë e veçantë</b> – zonë që ka veçori specifike dhe që kërkon regjim të posaçëm organizativ të përdorimit dhe të mbrojtjes nga Ministria, përmes Planit Hapësinor për Zona të Veçanta, e identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe në Hartën Zonale të Kosovës. Përkufizohet me Ligjin Nr. 04/L-174, për Planifikimin Hapësinor.</p>	<p>protection, preservation, management and promotion of values of the cultural heritage.</p> <p>1.48. <b>Heritage Value</b> – is the value embodied with material and spiritual heritage value including aesthetic, historical, scientific, social and spiritual values of past, present and to be transferred to the next generations.</p> <p>1.49. <b>Protected Area</b> – is the area defined according to the Law No. 04/L-174 on Spatial Planning.</p> <p>1.50. <b>Special Protected Area</b> – is the defined area according to the Law No. 03/L-039 on Special Protected Areas.</p> <p>1.51. <b>Special Area</b> – area that has specific characteristics and that requires special organizational regime of use and defense by Ministry through the Spatial Plan for Special Areas identified in the Spatial Plan of Kosovo and in Zonal Map of Kosovo. It is defined by Law No. 04/L-174 on Spatial Planning.</p>	<p>oçuvanje, administraciju i promovisanje vrednosti kulturnog nasleđa.</p> <p>1.48. <b>Nasledna vrednost</b> – je vrednost ugrađena sa materijalnim i duševnim nasleđem uključujući i estetsku, istorijsku, naučnu, socijalnu i duševnu vrednost prethodnih generacija, sadašnjih generacija i koje će se preneti na buduće generacije.</p> <p>1.49. <b>Zaštićena zona</b> – jeste zona definisana shodno zakonu za Br. 04/L-174. prostornog planiranja</p> <p>1.50. <b>Specijalna zaštićena zona</b> – jeste zona definisana shodno zakonu br. 03/L-039 za posebne zaštićene zone.</p> <p>1.51. <b>Posebna zona</b> – zona koja poseduje specifične karakteristike i koja zahteva poseban organizativan režim upotrebe i zaštite od strane ministarstva putem prostornog plana za specijalne zone, identifikovanih u karti zona na Kosovu. Definiše se zakonom br. 04/L-174 za prostorno planiranje.</p>
--	---	--

<b>KAPITULLI II KATEGORITË E TRASHËGIMISË KULTURORE</b>	<b>CHAPTER II CATEGORIES OF CULTURAL HERITAGE</b>	<b>POGLAVLJE II KATEGORIJE KULTURNOG NASLEĐA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Kategoritë e trashëgimisë kulturore</b></p> <p>Trashëgimia kulturore përbëhet nga trashëgimia arkeologjike, trashëgimia arkitekturore, trashëgimia e luajtshme, trashëgimia shpirtërore dhe peizazhet kulturore.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Categories of cultural heritage</b></p> <p>Cultural heritage consists of archaeological heritage, architectural heritage, movable heritage, spiritual heritage and cultural landscapes.</p>	<p style="text-align: center;"><b>član 4 Kategorije kulturnog nasleđa</b></p> <p>Kulturno nasleđe se sastoji od arheološkog nasleđa, arhitektonskog nasleđa, pokretnog nasleđa, duševnog nasleđa i kulturnih pejzaža.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5 Trashëgimia arkeologjike</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Trashëgimia arkeologjike definohet sipas nenit 3 pika 41.</li> <li>2. Objekte arkeologjike të paluajtshme janë monumentet, vendbanimet, strukturat e ndërtuara nga dora e njeriut me vlera historike, artistike, kulturore, arkeologjike dhe arkitekturore. Të tilla vlerësohen edhe objektet e kësaj natyre në gjendje rrënoje me vjetërsi mbi 100 - vjeçare.</li> <li>3. Objekte arkeologjike të luajtshme janë gjetjet nga gërmimet arkeologjike dhe gjetjet e rastit të krijuara nga dora e njeriut me vjetërsi mbi 100 - vjeçare.</li> <li>4. Prona e trashëgimisë arkeologjike</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5 Archaeological Heritage</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Archaeological Heritage is defined in accordance with Article 3 point 41.</li> <li>2. Archaeological objects are immovable monuments, settlements, structures built by the human hand with historical, artistic, cultural, archaeological and architectural values. Such are estimated, the objects of this nature in state of ruins with over 100 years of age.</li> <li>3. Movable archaeological objects are findings from archaeological excavations and occasional findings created by the human hand, and older than 100 years.</li> <li>4. Properties of the archaeological heritage</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5 Arheološko nasleđe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Arheološko nasleđe se definiše shodno članu 3 tačka 41.</li> <li>2. Nepokretni arheološki objekti su spomenici, naselja, strukture izgrađene čovekovom rukom od istorijske, umetničke, kulturne, arheološke i arhitektonske vrednosti. Kao takvim, procenjuju se i objekti ove prirode koje su ruševine starosti više od 100 godina.</li> <li>3. Pokretni arheološki objekti su namazi arheoloških iskopavanja i slučajni nalazi stvoreni čovekovom rukom, i stariji od 100 godina.</li> <li>4. Imovina arheološkog nasleđa koja se</li> </ol>

<p>brenda hapësirës së Kosovës është e shtetit të Kosovës.</p> <p>5. Konservimi dhe restaurimi i objekteve arkeologjike të luajtshme bëhet nga Muzeu i Kosovës dhe QKMTK-ja.</p> <p>6. Të gjitha objektet arkeologjike të luajtshme janë pronë e shtetit të Kosovës dhe ekspozohen në muzetë e Kosovës.</p> <p>7. Objektet arkeologjike të luajtshme mund të ekspozohen jashtë Kosovës me marrëveshje paraprake dhe me vendim të Ministrit.</p> <p>8. Prona e trashëgimisë arkeologjike brenda Kosovës është nën mbrojtje të shtetit.</p> <p>9. Të gjitha objektet e trashëgimisë arkeologjike që janë larguar nga Kosova gjatë periudhës së luftërave dhe gjendjeve të tjera të jashtëzakonshme duhet të kthehen në Kosovë.</p>	<p>within the area of Kosovo is of the state of Kosovo.</p> <p>5. Conservation and restoration of movable archaeological objects is carried out by the Museum of Kosovo and KCPCH and licenced persons.</p> <p>6. All movable archaeological objects are property of the state of Kosovo and are exhibited in museums of Kosovo.</p> <p>7. Movable archaeological objects can be displayed outside Kosovo with preliminary agreement and upon decision of the Minister.</p> <p>8. Property of the archaeological heritage within the area of Kosovo is under state protection.</p> <p>9. All of the objects of archaeological heritage which have been taken away from Kosovo during the period of wars and other extraordinary situations should be returned to Kosovo.</p>	<p>nalazi unutar prostora Kosova pripada državi Kosova.</p> <p>5. Konzervaciju i restauraciju pokretnih arheoloških objekata vrši muzej Kosova i KCZKN i licencovana lica.</p> <p>6. Svi pokretni arheološki objekti su vlasništvo države Kosova i izlažu se u muzejima Kosova.</p> <p>7. Pokretni arheološki objekti se mogu izlagati i van Kosova, sa preliminarnim sporazumom i odlukom ministra.</p> <p>8. Imovina arheološkog nasleđa unutar Kosova je pod državnom zaštitom.</p> <p>9. Svi objekti arheološkog nasleđa koji su odneseni sa Kosova tokom ratova i drugih vanrednih stanja, trebaju se vratiti na Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Trashëgimia arkitekturore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Architectural Heritage</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Arhitektonsko nasleđe</b></p>
<p>1. Trashëgimia arkitekturore përkufizohet sipas nenit 3 pika 42.</p>	<p>1. Architectural heritage is defined as per Article 3 point 42.</p>	<p>1. Arhitektonsko nasleđe se definiše shodno članu 3 tačka 42.</p>



<p>2. Prona e trashëgimisë arkitekturore brenda hapësirës së Kosovës është e shtetit të Kosovës.</p>	<p>2. Property of architectural heritage within the territory of Kosovo belongs to the state of Kosovo.</p>	<p>2. Imovina arhitektonskog nasleđa unutar kosovske teritorije pripada državi Kosova.</p>
<p>3. Trashëgimia arkitekturore është pjesë e trashëgmisë së paluajtshme. Ajo identifikohet, dokumentohet, mbrohet, ruhet dhe promovohet në pajtim me këtë ligj, konventat ndërkombëtare dhe praktikat bashkëkohore.</p>	<p>3. Architectural heritage is part of immovable heritage. It is identified, documented, protected, preserved and promoted in accordance with this law, international conventions and contemporary practices.</p>	<p>3. Arhitektonsko nasleđe je deo nepokretnog nasleđa. Isto se identifikuje, dokumentuje, štiti, čuva i promovise u skladu sa ovim zakonom, međunarodnim poveljama i modernim praksama.</p>
<p>4. Vlerësimi profesional për vlerat e pronave të trashëgimisë arkitekturore shënohet në Listën dhe Regjistrin e Trashëgimisë Kulturore.</p>	<p>4. Professional assessment for the values of the property of architectural heritage shall be noted on the List and the Registry of cultural heritage.</p>	<p>4. Profesionalna procena o vrednostima arhitektonskog nasleđa se beleži u listi i registru kulturnog nasleđa.</p>
<p>afatmesme dhe afatgjate për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.</p> <p>19. Lista dhe Regjistri hyjnë në fuqi pas miratimit nga Ministri dhe botohen në Gazetën Zyrtare.</p> <p>20. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje shenjëzohet me një shenjë të dukshme identifikuese sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria. Ministria me institucionet përgjegjëse vendosin shenjat në afat prej 90- ditësh nga dita e përcaktimit të statusit të trashëgimisë kulturore.</p> <p>21. Standardet dhe procedurat eshenjëzimit përcaktohen nga Ministria me një akt nënligjor në pajtim me këtë ligj.</p>	<p>mid-term and long-term protection, preservation and promotion of cultural heritage.</p> <p>19. List and Registry enter into force following approval by Minister and are published in Official Gazette.</p> <p>20. Cultural heritage under protection is marked by a visible identification sign according to the standards set by the Ministry. The Ministry with the responsible institutions place signs in a term of 90 days from the day of determination of the status of cultural heritage.</p> <p>21. Standards and procedures of marking shall be determined by the Ministry with a sub-legal act pursuant to this law.</p>	<p>dugoročne nacionalne strategije za zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturnog nasleđa.</p> <p>19. Lista i registar stupaju na snagu nakon usvajanja od strane ministra i isti se objavljuju u službenom glasniku.</p> <p>20. Kulturno nasleđe pod zaštitom se obeležava vidljivim identifikacionim znakom shodno standardima koje određuje ministarstvo. Ministarstvo zajedno sa odgovornim institucijama znakove postavlja u roku od 90 dana od datuma određivanja statute kulturnog nasleđa.</p> <p>21. Standardi i procedure obeležavanja određuju se od strane ministarstva podzakonskim aktom u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p><b>KAPITULLI V</b> <b>INSPEKTORATI</b></p> <p><b>Neni 27</b> <b>Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore</b></p>	<p><b>CHAPTER V</b> <b>INSPECTORATE</b></p> <p><b>Article 27</b> <b>Cultural Heritage Inspectorate</b></p>	<p><b>POGLAVLJE V</b> <b>INSPEKTORAT</b></p> <p><b>Član 27</b> <b>Inspektorat kulturnog nasleđa</b></p>
<p>1. Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore themelohet për inspektimin e trashëgimisë kulturore, i organizuar në nivel të Departamentit (në tekstin e mëtejme</p>	<p>1. The Inspectorate of Cultural Heritage is established for the inspection of the cultural heritage organized in the Department level (hereinafter the</p>	<p>1. Inspektorat kulturnog nasleđa se uspostavlja za vršenje inspekcije nad kulturnih nasleđem, organizovanog na nivou odeljenja (u daljem tekstu</p>

<p>Inspektorati).</p> <p>2. Inspektorati përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Kryeinspektori për punën e vet i përgjigjet drejtëpërdrejt Ministrit.</p> <p>3. Inspektorati ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p>3.1. Inspekton zbatimin e legjislacionit të trashëgimisë kulturore nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>3.2. Në mënyrë të pavarur inspekton integritetin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Listë dhe Regjistër;</p> <p>3.3. Urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të secilit veprim të paautorizuar ndaj trashëgimisë kulturore;</p> <p>3.4. Inspekton çështjet e shpronësimit, tjetërsimit, qarkullimit dhe masave sanksionuese.</p> <p>4. Të gjitha përgjegjësitë, detyrat, obligimet e Inspektoratit dhe procedurat e tjera të inspektimit rregullohen me akt nënligjor të bazuar në këtë ligj.</p>	<p>Inspectorate).</p> <p>2. Inspectorate consists of Chief Inspector and inspectors. Chief inspector shall report directly to the Minister for his work.</p> <p>3. Inspectorate has the following duties and responsibilities:</p> <p>3.1. Inspects the implementation of legislation of the cultural heritage by all natural and legal persons in the entire territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>3.2. Independently inspects the integrity and preservation of cultural heritage in the List and in the Registry;</p> <p>3.3. Orders immediate terminating of each unauthorized action to cultural heritage;</p> <p>3.4. Inspects in the issues of expropriation, alienation, circulation and sanction measures.</p> <p>4. All responsibilities, duties and obligations of the Inspectorate and other procedures of inspection are regulated by sub-legal act based on this law.</p>	<p>inspektorat).</p> <p>2. Inspektorat se sastoji od glavnog inspektora i inspektora. Glavni inspektor o svom radu direktno odgovara ministru.</p> <p>3. Inspektorat ima sledeće dužnosti i odgovornosti:</p> <p>3.1. Proverava sprovođenje zakonodavstva kulturnog nasleđa od strane shih fizičkih i pravnih lica na teritoriji Republike Kosova;</p> <p>3.2. Na nezavistan način proverava integritet i očuvanje kulturnog nasleđa u listi i registru;</p> <p>3.3. Naređuje hitan prekid svake neovlašćene akcije protiv kulturnog nasleđa;</p> <p>3.4. Proverava pitanja ekproprijacije, otuđivanja, kretanja i kaznenih mera.</p> <p>4. Sve odgovornosti, dužnosti, obaveze inspektorata i ostale procedure inspekcije, regulišu se podzakonskim aktom zasnovanom na ovom zakonu.</p>
--	---	---



<b>KAPITULLI VI INSTITUCIONET E TRASHËGIMISË KULTURORE</b>	<b>CHAPTER VI INSTITUTIONS OF CULTURAL HERITAGE</b>	<b>POGLAVLJE VI INSTITUCIJE KULTURNOG NASLEĐA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 28 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore</b></p> <p>1. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është agjenci e pavarur e krijuar nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>2. Anëtarët e KKTK – së emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i tyre është 3- vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.</p> <p>3. Këshilli ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. Shqyrton, vlerëson, aprovon apo refuzon trashëgiminë kulturore të propozuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Kosovës prioritete vjetore për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore.</p> <p style="padding-left: 20px;">3.3. I propozon Kuvendit ndërmarrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe i ofron Qeverisë këshilla për çështje të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28 Kosovo Council of Cultural Heritage</b></p> <p>1. Kosovo Council of Cultural Heritage (KCCH) is an independent body created by the Assembly of Kosovo.</p> <p>2. Members of KCCH are appointed by the Assembly of Republic of Kosovo. Their mandate is 3 years and with the possibility of reappointment.</p> <p>3. Council has the following duties and responsibilities:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. Examines, evaluates, approves or rejects cultural herita proposed in the List of Cultural Heritage under Permanent Protection.</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. Identifies and proposes a priority for financial support of cultural heritage for each year by the Assembly of Kosovo.</p> <p style="padding-left: 20px;">3.3. Proposes to the Assembly undertaking measures for preservation and protection of cultural heritage and provides advicee to Government for</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28 Kosovski savet za kulturno nasleđe</b></p> <p>1. Kosovski savet za kulturno nasleđe (KSKN) je nezavisna agencija koju uspostavlja skupština Kosova.</p> <p>2. Članove KCNZ-a imenuje skutina Republike Kosova. Njihov mandate traje 3 godina, sa mogućnoscu ponovnog biranja.</p> <p>3. Savet ima sledeće dužnostiodgovornosti:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. Razmatra, procenjuje, suvaja ili odbija kulturno nasleđe na listi za stalnu zaštitu.</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. Identifikuje i skupštini Kosova predlaže godišnje prioritete za finansijsku podršku kulturnog nasleđa.</p> <p style="padding-left: 20px;">3.3. Skupštini predlaže preduzimanje mera za očuvanje i zaštitu kulturnog nasleđa i vladu s avetuje o pitanjima kulturnog nasleđa.</p>

<p>trashëgimisë kulturore;</p> <p>3.4. Bashkëpunon me Ministrinë dhe Institucionete tjera relevante për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues të KKTK-së</b></p> <p>1. KKTK-ja përbëhet nga 7 anëtarë. Anëtarët e Këshillit duhet të jenë profesionistë të trashëgimisë kulturore, profesionistë të lëmive të përafërta ose njohës të legjislacionit të kësaj fushe.</p> <p>2. Anëtarët e KKTK-së zgjedhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Me rekomandimin e Ministrit, Qeveria i propozon Kuvendit dyfishin e kandidatëve për t'u zgjedhur anëtarë të KKTK-së.</p> <p>3. Funksionimi, organizimi i brendshëm dhe procedurat e vendimmarrjes së KKTK-së rregullohen me akt nënligjor i cili miratohet nga Kryesia e Kuvendit të</p>	<p>issues of cultural heritage.</p> <p>3.4. Cooperates with the Ministry and other relevant institutions for issues about protection and preservation of cultural heritage of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Composition and the way of appointment of members of the Steering Committee of KCCH</b></p> <p>1. The Steering Committee of KCCH consists of 7 members. Members of the Committee shall be professionals of the cultural heritage, professional or other related fields, good connoisseur of the legislation of this field.</p> <p>2. Members of the Steering Committee shall be appointed by the Assembly of the Republic of Kosovo. Upon recommendation of the Minister, the Government proposes to the Assembly the twice number of candidates to be appointed as members of the Steering Committee.</p> <p>3. Functioning, the internal organization and the decision-making procedures of the Committee, shall be regulated by sub-legal act which is approved by the Presidency of</p>	<p>3.4. Sarađuje sa implementaciono nadglednim savetom (INS) za pitanja koja se tiču zaštite i očuvanja kulturnog nasleđa u Republici Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 29</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Sastav i način selekcije članova upravnog saveta KSKN-a</b></p> <p>1. Upravni savet KSKN-a se sastoji od 7 članova. Članovi saveta trebaju biti stručnjaci kulturnog nasleđa, stručnjaci približnih oblasti ili poznavalaci zakonodavstva iz ove oblasti.</p> <p>2. Članovi upravnog saveta se biraju iz skupštine Republike Kosova. Preporukom ministra, vlada skupštini predlaže dva put veći broj kandidata kako bi se izabrao dovoljan broj članova upravnog odbora.</p> <p>3. Funkcionisanje, organizacija i procedure donošenja odluka saveta, regulišu se podzakonskim aktom koji usvaja predsedništvo skupštine Kosova.</p>
---	--	---

<p>Kosovës.</p> <p>4. KKTK-ja për punën e vet i raporton Kuvendit të Kosovës së paku një herë në vit.</p> <p>5. Buxheti për punën e KKTK – së sigurohet nga Kuvendi i Kosovës.</p>	<p>the Assembly of Kosovo.</p> <p>4. SCCH for its work shall report to the Assembly of Kosovo at least once a year.</p> <p>5. The budget for the work of Committee is provided by the Assembly of Kosovo.</p>	<p>4. KSKN o svom radu najmanje jednom godišnje izveštava skupštini Kosova.</p> <p>5. Budžet za rad saveta se obezbeđuje iz skupštine Kosova.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Institucionet përgjegjëse</b></p> <p>1. Institucionet e trashëgimisë kulturore në vartësi të Ministrisë janë:</p> <p>1.1. Instituti i Arkeologjisë i Kosovës (më tutje IAK);</p> <p>1.2. Qendra e Kosovës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;</p> <p>1.3. Muzeu i Kosovës;</p> <p>1.4. Muzeu i Natyrës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Responsible Institutions</b></p> <p>1. Cultural heritage institutions under the Ministry are:</p> <p>1.1. Institute of Archeology of Kosovo (hereinafter IAK);</p> <p>1.2. Kosovo Center for Protection of Cultural Heritage;</p> <p>1.3. Museum of Kosovo;</p> <p>1.4. Nature Museum;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Odgovorne institucije</b></p> <p>1. Institucije kulturnog nasleđa u nadležnosti ministarstva su:</p> <p>1.1. Arheološki Institut Kosova (u daljem tekstu AIK);</p> <p>1.2. Kosovski centar za zaštitu kulturnog nasleđa;</p> <p>1.3. Muzej Kosova;</p> <p>1.4. Muzej prirode.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Instituti i Arkeologjisë i Kosovës</b></p> <p>1. Instituti i Arkeologjisë i Kosovës është institucion shkencor, i cili hulumton dhe gërmon trashëgiminë arkeologjike dhe</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Institute of Archeology of Kosovo</b></p> <p>1. Institute of Archeology of Kosovo is scientific institution which explores and excavates for archaeological heritage and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Arheološki institut Kosova</b></p> <p>1. Arheološki institut Kosova je naučna institucija koja istražuje i iskopava arheološko nasleđe i objavljuje svoju</p>

<p>boton veprimtarinë e tij shkencore.</p> <p>2. Instituti i Arkeologjisë i Kosovës ka Këshillin Drejtues, drejtorin, stafin profesionist dhe administrative.</p> <p>3. Instituti i Arkeologjisë i Kosovës harton Statutin, Strategjinë, Planin vjetor dhe Raportin vjetor.</p> <p>4. Mandati dhe mënyra e funksionimit të IAK-ut përcaktohet në Statutin e tij, në pajtim me këtë ligj, të cilin e miraton Ministri</p>	<p>publishes its scientific activity;</p> <p>2. Institute of Archeology of Kosovo has a Steering Committee, the Director, professional and administrative staff;</p> <p>3. The Institute of Archeology of Kosovo drafts statute, strategy, annual plan and annual report;</p> <p>4. Mandate and the functioning of IAK is determined in its statute in accordance with this law approved by Minister.</p>	<p>naučnu delatnost.</p> <p>2. Arheološki institut Kosova ima soj upravni savet, direktora, stručno i administrativno osoblje.</p> <p>3. Arheološki Institut Kosova priprema statut, strategiju, godišnji plan godišnji izveštaj.</p> <p>4. Mandat i način funkcionisanja AIK-a se određuje statutom u skladu sa ovim zakonom koji usvaja ministar.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Qendra e Kosovës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Kosovo Center for Protection of Cultural Heritage</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Kosovski centar za zaštitu kulturnog nasleđa</b></p>
<p>1. Qendra e Kosovës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (QKMTK) është institucioni kryesor nën vartësi të Ministrisë që mbron, ruan dhe konservon trashëgiminë kulturore të Kosovës.</p> <p>2. QKMTK-ja konservon dhe restauron trashëgiminë kulturore dhe bën gërmime arkeologjike me karakter shpëtimi.</p> <p>3. QKMTK-ja ka Këshillin Drejtues, drejtorin, stafin profesionsit dhe administrativ.</p> <p>4. QKMTK-ja harton Statutin, Strategjinë,</p>	<p>1. KosovoCenter forProtection of Cultural Heritage-KCPCH is the main institution subordinated to Ministry that protects, preserves and conserves cultural heritage of Kosovo.</p> <p>2. KCPCH conserves and restores cultural heritage and carries out archaeological excavations with rescue character;</p> <p>3. KCPCH has a Steering Committee, the Director, professional and administrative staff;</p> <p>4. KCPCH drafts statute, strategy, annual</p>	<p>1. Kosovski centar za zaštitu kulturnog nasleđa-KCZKN je glavna institucija pod nadležnosti ministarstva, koji brani, čuva i obnavlja kulturno nasleđe Kosova.</p> <p>2. KCZKN konzervira i vrši restauraciju kulturnog nasleđa i vrši arheološka iskopavanja spasalačkog karaktera;</p> <p>3. KCZKN ima upravni savet, direktora, stručno i administrativno osoblje;</p> <p>4. KCZKN priprema statut, strategiju,</p>

<p>Planin vjetor dhe Raportin vjetor;</p> <p>5. Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore do të jenë në vartësi të QKMTK – së dhe të gjitha resurset, punëtorët dhe aspektet tjera të funksionimit do të jenë në përgjegjësi të QKMTK – së jo më larg se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p>6. Mandati dhe mënyra e funksionimit të QKMTK-së përcaktohet në Statutin e saj, në pajtim me këtë ligj, të cilin e miraton Ministri</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Muzeu i Kosovës</b></p> <p>1. Muzeu i Kosovës është institucion që ruan, hulumton, prezanton dhe promovon trashëgiminë kulturore të luajtshme.</p> <p>2. Muzeu i Kosovës ka Këshillin Drejtues, drejtorin, stafin profesionsit dhe administrativ.</p> <p>3. Muzeu i Kosovës harton Statutin, Strategjinë, Planin vjetor dhe Raportin vjetor.</p> <p>4. Mandati dhe mënyra e funksionimit të Muzeut të Kosovës përcaktohet në Statutin e tij në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin e veçantë për Muzetë.</p>	<p>plan and annual report;</p> <p>5. Regional Centers for Cultural Heritage will be subordinate to KCPCCH and all resources, employees and other aspects of the functioning will fall under the responsibility of KCPCCH no later than 6 months after the entry into force of this law.</p> <p>6. Mandate and the functioning of KCPCCH is determined in its statute in accordance with this law approved by Minister.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Museum of Kosovo</b></p> <p>1. Museum of Kosovo is an institution that preserves, explores, presents and promotes movable cultural heritage;</p> <p>2. Museum of Kosovo has a Steering Committee, the Director, professional and administrative staff;</p> <p>3. Museum of Kosovo drafts statute, strategy, annual plan and annual report;</p> <p>4. Mandate and the functioning of Museum of Kosovo is determined in its statute in accordance with this law and the special law on museums.</p>	<p>godišnji plan i godišnji izveštaj;</p> <p>5. Regionalni centar za kulturno nasleđe biće pod nadležnosti KCZKN i svi resursi, radnici i ostali aspekti funkcionisanja, spadaju pod odgovornošću KCZKN-a ne više od 6 meseci nakon stupanja ovog zakona na snagu.</p> <p>6. Mandat i način funkcionisanja KCZKN-a određuje se statutom u skladu sa ovim zakonom koji usvaja ministar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Muzej Kosova</b></p> <p>1. Muzej Kosova je institucija koja čuva, istražuje, predstavlja i promoviše pokretno kulturno nasleđe;</p> <p>2. Muzej Kosova ima upravni odbor, direktora, stručno i administrativno osoblje;</p> <p>3. Muzej Kosova priprema statut, strategiju, godišnji plan i godišnji izveštaj;</p> <p>4. Mandat i način funkcionisanja muzeja Kosova određuje se u njegovom statutu i posebnim zakonom za muzeje.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Muzeu i Natyrës</b></p> <p>1. Muzeu i Natyrës do të jetë institucion që ruan, hulumton, konservon, prezanton dhe promovon trashëgiminë natyrore të Kosovës.</p> <p>2. Muzeu i Natyrës do të ketë Këshillin Drejtues, drejtorin, stafin profesional dhe atë administrativ.</p> <p>3. Muzeu i Natyrës harton Statutin, Strategjinë, Planin vjetor dhe Raportin vjetor.</p> <p>4. Muzeu i Natyrës do të formohet jo më larg se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p>5. Mandati dhe mënyra e funksionit të Muzeut të Natyrës do të përcaktohet në Statutin e tij, në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin e veçantë për Muzetë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Nature Museum</b></p> <p>1. The Museum of Nature will be an institution that preserves, explores, conserves, presents and publishes natural heritage of Kosovo.</p> <p>2. The Museum of Nature has a Steering Committee, the Director, professional and administrative staff.</p> <p>3. Museum of Nature drafts statute, strategy, annual plan and annual report;</p> <p>4. The Museum of Nature will be formed no later than 6 months after the entry into force of this law.</p> <p>5. Mandate and the functioning of Museum of Nature is determined in its statute in accordance with this law and the special law on museums.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Muzej prirode</b></p> <p>1. Muzej prirode biće institucija koja čuva, istražuje, čuva, predstavlja i promovise prirodno nasleđe Kosova.</p> <p>2. Muzej Kosova će i mati svoj upravni odbor, direktora, stručno i administrativno osoblje;</p> <p>3. Muzej prirode priprema statut, strategiju, godišnji plan i godišnji izveštaj.</p> <p>4. Muzej prirode će se formirati ne kasnije od 6 meseci nakon stupanja ovog zakona na snagu.</p> <p>5. Mandat i način funkcionisanja mezeja prirode određuje se njegovim statutom u skladu sa ovim zakonom i posebnim zakonom za muzeje.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Themelimi i institucioneve</b></p> <p>Me propozimin e Ministrisë, Qeveria e Kosovës themelon institucione të trashëgimisë kulturore. Kriteret dhe procedurat për themelimin e institucioneve</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Establishment of institutions</b></p> <p>Upon the proposal of the Ministry, the Government of Kosovo shall establish Institutions of cultural heritage. Criteria and procedures for the establishment of the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Osnivanje institucija</b></p> <p>Predlogom ministarstva, vlada Kosova osniva institucije kulturnog nasleđa. Kriterijumi i procedure za osnivanje institucija kulturnog nasleđa određuju se</p>

<p>të trashëgimisë kulturore përcaktohen me një akt nënligjor, të cilin e nxjerrë Ministria.</p>	<p>cultural heritage institutions shall be determined by a sub legal act issued by the Ministry.</p>	<p>podzakonskim aktom koji izdaje ministarstvo.</p>
<p><b>KAPITULLI VII KONCESIONET</b></p>	<p><b>CHAPTER VII CONCESSIONS</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VII KONCESIJE</b></p>
<p><b>Neni 36 Shitja dhe shpronësimi i trashëgimisë kulturore</b></p>	<p><b>Article 36 Selling and expropriation of the cultural heritage</b></p>	<p><b>Član 36 Prodaja i eksproprijacija kulturnog nasleđa</b></p>
<p>1. Trashëgimia kulturore e luajtshme që është në pronësi private mund të shitet, trashëgohet ose dhurohet vetëm brenda territorit të Kosovës, me njoftim dhe pëlqim nga Ministria.</p> <p>2. Prona e paluajtshme e trashëgimisë kulturore mund të shpronësohet duke u mbështetur në kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-139, për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme, në rastet si në vijim:</p> <p>2.1. Kur paraqitet rreziku i dëmtimit të qëllimshëm ose shkatërrimit të trashëgimisë kulturore;</p> <p>2.2. Kur nuk është ndërmarrë veprim i mjaftueshëm nga pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi për të mbrojtur dhe ruajtur vlerën e trashëgimisë kulturore;</p>	<p>1. Movable cultural heritage that is privately owned, may be sold, inherited or donated within the territory of Kosovo, with notice and consent by the Ministry.</p> <p>2. The immovable property of cultural heritage may be expropriated by relying on the conditions specified in the Law No. 03/L-139 on Expropriation of Immovable Property, in the following cases:</p> <p>2.1. When there is risk of intentional damage or destruction of Cultural Heritage;</p> <p>2.2. When insufficient action has been undertaken by the owner, possessor or beneficiary to protect and preserve the value of Cultural Heritage;</p>	<p>1. Pokretno kulturno nasleđe koje je u privatnom vlasništvu, može se prodavati, naslediti ili poklonoti ali samo unutar Kosovske teritorije, obaveštavanjem i dobijanjem dozvole ministarstva.</p> <p>2. Nepokretna imovina kulture baštine može biti predmet eksproprijacije, oslanjajući se na oslovima određenih zakonom br. 03/L-139 za ekproprijaciju nepokretne imovine, i to u sledećim slučajevima:</p> <p>2.1. Kada se pojavi opasnost namernog oštećivanja ili uništavanja kulturnog nasleđa;</p> <p>2.2. Kada vlasnik, posednik ili korisnik nije preduzeo dovoljno akcija, za zaštitu i očuvanje vrednosti kulturnog nasleđa;</p>

<p>2.3. Kur vlerësohet interesi nacional i një prone të trashëgimisë kulturore;</p> <p>2.4. Ministria konsulton KKTK – në para se të marrë vendimin për shpronësim;</p> <p>2.5. Pronari i pronës së paluajtshme në të cilën është gjetur trashëgimia arkeologjike dhe e cila vendoset të shpronësohet kompensohet sipas Ligjit Nr. 03/L-139, për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Koncesionimi i pronave publike të trashëgimisë kulturore</b></p> <p>1. Trashëgimia kulturore e paluajtshme e përfshirë në Listë dhe Regjistër mund të jepet në shfrytëzim përmes koncesionit, me pëlqimin e pronarit, me qëllim të ruajtjes, mirëmbajtjes sistematike dhe shfrytëzimit për arritjen e objektivave ekonomike, sociale dhe kulturore.</p> <p>2. Ministria është përgjegjëse për menaxhim të pronave të trashëgimisë kulturore, të cilat janë në pronësi të shtetit.</p> <p>3. Ministria krijon Bazën e të Dhënave për</p>	<p>2.3. When national interest of a property is estimated for Cultural Heritage;</p> <p>2.4. Ministry, consults KCCH before taking the decision on expropriation;</p> <p>2.5. The owner of the immovable property in which the Archaeological Heritage has been found and decided to expropriate, compensated according to Law No. 03/L-139 on Expropriation of Immovable Property</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Concession of Public Property of the Cultural Heritage</b></p> <p>1. The immovable cultural heritage included in the List and Registry may be given for use through concession, with the consent of the owner, with aim of preservation, systematic maintenance and use for achievement of economic, social and cultural objectives.</p> <p>2. The Ministry is responsible for management of cultural heritage property, which are owned by the state.</p> <p>3. Ministry establishes a database for all</p>	<p>2.3. Kada se proceni nacionalni interes neke imovine kulturnog nasleđa;</p> <p>2.4. Ministarstvo, pre donošenja odluke o ekproprijaciji prvo konsultuje KSKN;</p> <p>2.5. Vlasnik nepokretne imovine na kojoj je pronađeno arheološko nasleđe i koja je predmet ekproprijacije, nadoknađuje se shodno zakonu br. 03/L 139 za ekproprijaciju nepokretne imovine.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Koncesija javne imovine kulturnog nasleđa</b></p> <p>1. Nepokretno kulturno nasleđe zavedeno u listi i registru, može se dati na korišćenje putem koncesije, odobrenjem vlasnika, sa ciljem očuvanja, sistematskog održavanja i korišćenja za postizanje ekonomskih, socijalnih i kulturnih ciljeva.</p> <p>2. Ministarstvo je odgovorno za upravljanje imovinama kulturnog nasleđa, koje su vlasništvo države.</p> <p>3. Ministarstvo stvara bazu podataka za</p>
--	---	--



<p>të gjitha pronat e trashëgimisë kulturore në pronësi të shtetit me potenciale për koncesion.</p>	<p>properties of Cultural Heritage in state ownership with potential for concession.</p>	<p>sve imovine kulturnog nasleđa u vlasništvu države sa potencijalom za koncesiju.</p>
<p>4. Ministria së bashku me institucionet përgjegjëse hartojnë planet e menaxhimit për pronat e trashëgimisë kulturore që janë nën pronësi të shtetit.</p>	<p>4. The Ministry together with the responsible institutions draft management plans for the properties of culture heritage that are under state ownership.</p>	<p>4. Ministarstvo zajedno sa odgovornim institucijama, pripremaju upravne planove za imovine kulturnog nasleđa koje su pod državnim vlasništvom.</p>
<p>5. Ministria, në bazë të kriterëve të përcaktuara, bën lajmërimin për dhënien në koncesion të trashëgimisë kulturore. Procesi i koncesionimit është transparent dhe i hapur për publikun.</p>	<p>5. Ministry on the basis of the specified criteria notifies for granting concession of the cultural heritage. The concession process is transparent and open to the public.</p>	<p>5. Na osnovu određenih kriterijuma, ministarstvo vrši obaveštenje za davanje kulturnog nasleđa pod koncesijom. Proces koncesije je transparentan i otvoren za javnost.</p>
<p>6. Shpallja publike për koncesion duhet të përmbajë të dhënat dhe kriteret për ruajtjen dhe mbrojtjen e pronave të trashëgimisë kulturore që i përcakton Ministria.</p>	<p>6. Public announcement for concession shall contain the information and criteria for the preservation and protection of cultural heritage properties which are determined by the Ministry.</p>	<p>6. Javno objavljivanje za koncesiju treba sadržati podatke i kriterijume za očuvanje i zaštitu imovine kulturnog nasleđa koje određuje ministarstvo.</p>
<p>7. Vendimi për koncesionim të pronës së trashëgimisë kulturore merret nga Ministria.</p>	<p>7. The decision for concession of property of the cultural heritage is taken by the Ministry.</p>	<p>7. Odluku za davanje imovine kulturnog nasleđa pod koncesijom, donosi ministarstvo.</p>
<p>8. Ministria mban Regjistrin në të cilin regjistrohen kontratat e koncesionit.</p>	<p>8. The Ministry shall maintain the Registry in which the concession contracts are registered.</p>	<p>8. Ministarstvo vodi registar u kojem se registruju ugovori koncesije.</p>
<p>9. Të ardhurat nga koncesionimi i pronave të trashëgimisë kulturore në pronësi publike i takojnë Qeverisë së Kosovës.</p>	<p>9. Income from concession of properties of cultural heritage in public ownership belonging to the Government of Kosovo.</p>	<p>9. Prihodi iz koncesije imovine kulturnog nasleđa u javnom vlasništvu pripadaju vladi Kosova.</p>

<p>10. Procedurat e koncesionimit të trashëgimisë kulturore rregullohen me akt nënligjor të bazuar në këtë ligj.</p>	<p>10. Cultural Heritage concession procedures are regulated by sub-legal act based on this law.</p>	<p>10. Procedure za davaje imovinekulturnog nasleđa pod koncesiju, regulišu se podzakonskim aktom u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p><b>KAPITULLI VIII</b></p>	<p><b>CHAPTER VIII</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VIII</b></p>
<p><b>Neni 38</b> <b>Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore</b></p>	<p><b>Article 38</b> <b>Financing and fiscal measures for the cultural heritage</b></p>	<p><b>Član 38</b> <b>Finansiranje i fiskalne mere za kulturno nasleđe</b></p>
<p>1. Fondet për hulumtimin, inventarizimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, prezantimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore sigurohen nga buxheti i Ministrisë, nga buxheti i komunave dhe burimeve të tjera si grante, donacione, sponsorizime dhe përmes të hyrave vetanake.</p>	<p>1. Funds for the research, inventory, documentation, selection, protection, conservation, restoration, administration, presentation and promotion of cultural heritage, shall be provided from the budget of the Ministry, from the budget of municipalities and other resources as well as grants, donations, sponsorships and through own source revenues.</p>	<p>1. Fondovi za istraživanje, popisivanje, dokumentovanje, selekciju, zaštitu, konzervaciju, restauraciju, administraciju, predstavljanje i promovisanje kulturnog nasleđa, obezbeđuju se iz budžeta ministarstva, iz opštinskih budžeta i ostalih izvora kao što su grantovi, donacije, sponzori i putem samostalnih prihoda.</p>
<p>2. Pronat e trashëgimisë kulturore që gjenden në Listë dhe Regjistër lirohen nga tatimi mbi pronën, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>2. Properties of cultural heritage, which are on the List and Registry shall be exempt from property tax, in accordance with applicable legislation.</p>	<p>2. Imovine kulturnog nasleđa koje se nalaze na listi i registru, oslobađaju se od poreza na imovinu, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
<p>3. Çdo financim me qëllim intervenimi në trashëgiminë kulturore të mbrojtur nga personat fizikë ose juridikë, shumat e të cilave janë të konfirmuara dhe aprovuara nga institucioni përgjegjës, lirohet nga detyrimi për tatim në të hyra, deri në vlerën e shumës së financiar, nëse kjo nuk</p>	<p>3. Any funding intended for intervention in cultural heritage protected by natural or legal persons, amounts of which are confirmed and approved by responsible institution, is released from the obligation of income tax, up to the value of the financed amount, if it is not otherwise</p>	<p>3. Svako finansiranje za vršenje intervencija na zaštićenom kulturnom nasleđu, od strane fizičkog ili pravnog lica, iznos kojih je potvrđen i odobren od strane odgovorne institucije, oslobađa se od obaveze plaćanja poreza na prihode, sve do iznosa finansirane vrednosti, ako drugačije</p>

<p>është rregulluar ndryshe me ndonjë ligj tjetër në fuqi.</p> <p>4. Procedurat e financimit për intervenim, konservim dhe ndërhyrje përcaktohen me akt nënligjor të bazuar në këtë ligj.</p> <p><b>KAPITULLI IX KOMISIONI I ANKESAVE DHE SANKSIONET</b></p> <p><b>Neni 39 Ankesat</b></p> <p>1. Kundër vendimeve të Ministrisë dhe institucioneve vartëse të saj, pala ka të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.</p> <p>2. Procedurat e ankimimit dhe përbërja e Komisionit rregullohen me një akt nënligjor të miratuar nga Ministria.</p> <p><b>Neni 40 Sanksionet</b></p> <p>1. Shkeljet vijuese sanksionohen dhe dënohen me gjobë, kur nuk përbëjnë vepër penale, si në vijim:</p>	<p>regulated by any other applicable law.</p> <p>4. Procedures of funding for intervention, conservation and intervention shall be defined by sub-legal act based on this law.</p> <p><b>CHAPTER IX COMPLAINTS AND SANCTIONS COMMITTEE</b></p> <p><b>Article 39 Complaints</b></p> <p>1. The party shall have the right to exercise legal remedy against the decision of Ministry and subordinate institutions, in accordance with the Law on Administrative Conflict.</p> <p>2. Grievance procedures and composition of the committee are regulated by a sub-legal act approved by the Ministry.</p> <p><b>Article 40 Sanctions</b></p> <p>1. The following violations are sanctioned by fine, if they do not constitute a criminal offense, as follows:</p>	<p>nije regulisano nekih drugim važećim zakonom.</p> <p>4. Pocerure finansiranja za intervenciju, konzervaciju i intervencije, određuju se podzakonskim aktom na osnovu ovog zakona.</p> <p><b>POGLAVLJE IX KOMISIJA ZA ZALBE I KAZNE</b></p> <p><b>Član 39 Žalbe</b></p> <p>1. Protiv odluka Ministarstva i njenih institucija, stranka ima pravo na koriscenje pravnog sredstva u skladu sa zakonom za administrativni spor.</p> <p>2. Pocerure žalbe i sastav komisije, regulisu se podzakonskim aktom koji usvaja ministarstvo.</p> <p><b>Član 40 Kazne</b></p> <p>1. Sledeći prekršaji se kažnjavaju novčanom kaznom, kada ne predstavljaju krivično delo, i to:</p>
---	---	---

<p>1.1. Shkeljet sipas Nenit 4 pika 7, Nenit 6 pika 10, Nenit 8 pika 4 dhe 5, Nenit 9 pika 3, Nenit 14 pika 5, nenit 15 pika 2 dënohen me gjobë prej 1.000 € (një mijë euro) – 10.000 € (dhjetë mijë euro);</p> <p>1.2. Shkeljet sipas Nenit 14 pika 3 dhe 4 dënohen me gjobë prej 5.000 € (pesë mijë euro) – 20.000 € (njëzet mijë) euro;</p> <p>1.3. Shkeljet sipas Nenit 6 pika 11, Nenit 13 pika 3 dënohen me gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) – 40.000 (dyzet mijë) euro;</p> <p>1.4. Shkeljet sipas Nenit 6 pika 3 dhe 7, Nenit 25 pika 1, Nenit 26 pika 2 dënohen me gjobë prej 20.000 € (njëzet mijë euro) – 100.000 (njëqind mijë) euro;</p> <p>1.5. Shkeljet sipas Nenit 4 pika 2, Nenit 6 pika 2, dënohen me gjobë prej 30.000 € (tridhjetë mijë euro) – 120.000 (njëqind e njëzet mijë euro);</p> <p>2. Çdo person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, duke shkelur dispozitat e këtij ligji, përbën vepër</p>	<p>1.1. Violations under Article 4, item 7, Article 6 paragraph 10, Article 8, paragraph 4 and 5, Article 9 paragraph 3, Article 14, paragraph 5, Article 15 paragraph 2 shall be liable to a fine from 1.000 € (one thousand Euros) - 10.000 € ( ten thousand Euros);</p> <p>1.2. Violations under Article 14, item 3 and 4 are punishable by a fine of 5.000 € (five thousand Euros) - 20.000 € (twenty thousand) Euros;</p> <p>1.3. Violations under Article 6, item 11, Article 13 paragraph 3 shall be liable to a fine of 10.000 (ten thousand) - 40,000 (forty thousand) Euros;</p> <p>1.4. Violations under Article 6, item 3 and 7, Article 25, paragraph 1, Article 26 paragraph 2 punishable by a fine of 20,000 € (twenty thousand Euros) - 100.000 (one hundred thousand ) Euros;</p> <p>1.5. Violations under Article 4, item 2 Article 6 item 2, are punishable by fine of 30,000 € (three hundred thousand Euros) - 120,000 (one hundred and twenty thousand Euros);</p> <p>2. Any natural or legal person who damages cultural heritage, regardless of their relations with property, by violating the provisions of this law, constitutes a</p>	<p>1.1. Prekršaji iz člana 4 tačka 7, člana 6 tačka 10, člana 8 tačka 4 i 5, člana 9 tačka 3, člana 14 tačka 5, člana 15 tačka 2, kažnjavaju se kaznom od 1.000 € (hiljadu evra) – 10.000 € (deset hiljada evra);</p> <p>1.2. Prekršaji iz člana 14 tačka 3 i 4, kažnjavaju se kaznom od 5.000 € (pet hiljada evra) – 20.000 € (dvadeset hiljada evra);</p> <p>1.3. Prekršaji iz člana 6 tačka 11, član 13 tačka 3, kažnjavaju se kaznom od 10.000 (deset hiljada) – 40.000 (četrdeset hiljada) evra;</p> <p>1.4. Prekršaji iz člana 6 tačka 3 i 7, člana 25 tačka 1, člana 26 tačka 2, kažnjava se kaznom od 20.000€ (dvadeset hiljada evra) – 100.000 (sto hiljada) evra;</p> <p>1.5. Prekršaji iz člana 4 tačka 2, član 6 tačka 2, kažnjava se kaznom od 30.000 € ( trideset hiljada evra) – 120.000 (stodvadeset hiljada evra);</p> <p>2. Svako fizičko ili pravno lice koje nanese štetu kulturnom nasleđu, nezavisno od imovinskih odnosa sa istim, kršeći odredbe ovog zakona, čini krivično delo i kažnjava</p>
--	---	---

<p>penale dhe dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Procedurat e sanksionimit rregullohen me një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj.</p> <p><b>KAPITULLI X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</b></p> <p><b>Neni 41 Shfuqizimi dhe nxjerrja e akteve të reja nënligjore</b></p> <p>1. Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr 02/L-88, për Trashëgiminë Kulturore, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 9 tetor 2006.</p> <p>2. Ministria është e obliguar që në afat prej 6 muajsh nga dita e miratimit të ligjit të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj.</p> <p>3. Aktet nënligjore që janë nxjerrë në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 mbesin në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, me kusht që këto akte të mos jenë kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p>	<p>criminal offense and is punishable by the relevant provisions of the Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Sanctioning procedures are regulated by a sub-legal act based on this law.</p> <p><b>CHAPTER X TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 41 Repeal and issuance of new sub-legal acts</b></p> <p>1. This Law shall repeal Law No. 02/L-88 on Cultural Heritage, adopted by Kosovo Assembly on 9 October 2006.</p> <p>2. The Ministry is obliged within the period of six (6) months from the date of adoption of the law, to issue all acts that derive from this law.</p> <p>3. Sub-legal acts that are issued in accordance with Law No. 02/L-88, continue to remain in force until the issuance of sub-legal acts provided for by this Law, under the condition that they are not contrary to the provisions of this Law.</p>	<p>se shodno relevantnim odredbama krivičnog zakona Republike Kosova.</p> <p>3. Kaznene procedure se regulišu podzakonskim aktom zasnovanog na ovom zakonu.</p> <p><b>POGLAVLJE X PROLAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 41 Ukidanje i izdavanje novih podzakonskih akata</b></p> <p>1. Ovaj zakon ukida zakona br. 02/L-88 o kulturnom nasleđu, koji je Skupština Kosova usvojila 9 oktobra 2006 godine.</p> <p>2. Ministarstvo je dužno da u roku od 6 meseci od dana usvajanja zakona, izda sve podzakonske akte koji proizilaze iz ovog zakona.</p> <p>3. Podzakonski akti koji su izdati naosnovu zakona br. 02/L-88, ostaju na snazi sve do donošenja novih podzakonskih akata predviđenih ovim zakonom, pod uslovom da nisu u suprotnosti za odredbama ovog zakona.</p>
--	---	---

<p align="center"><b>Neni 42</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p>	<p align="center"><b>Article 42</b> <b>Entering into force</b></p>	<p align="center"><b>Član 42</b> <b>Stupanje na snagu</b></p>
<p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p align="center">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>This Law enters into force fifteen (15) days following its' publication on "Official Gazette" of the Republic of Kosovo.</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p align="center">President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja istog u službenom glasniku Republike Kosova.</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p align="center">Predsednik Skupštine Republike Kosova</p>